



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" PRISHTINË

REPUBLIKA E KOSOVËS—REPUBLIC OF KOSOVA—REPUBLIKA KOSOVA	
INSTITUTI I HISTORISË—INSTITUTE OF HISTORY—INSTITUT ZA ISTORIJU	
Nr. i Org. Org. that Org. Juri.	IH
Nr. i prot. Prot.N. Br.Prot.	01172124
Nr. i Faqeve No. Pages	10 f.
Date: Datum:	14.10.2024
PRISHTINË - A	

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013) neni 23 paragrafi 5, të Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" neni 19 paragrafi 1 pika a, Këshilli Drejtues, në mbledhjen e vet të mbajtur më 10.10. 2024, nxori këtë:

RREGULLORE PËR VEPRIMTARINË BOTUESE TË INSTITUTI TË HISTORISË "ALI HADRI"

Neni 1 Qëllimi

1. Rregullorja përcakton standardet dhe kriteret për zhvillimin dhe realizimin e veprimtarisë botuese të Institutit të Historisë "Ali Hadri" (më tej Instituti).

Neni 2 Veprimtaria botuese

1. Instituti si institucion shkencor dhe botues, përgatit, realizon dhe boton, veprat e miratuara për botim nga Këshilli Shkencor, me autorë dhe studiues të brendshëm dhe të jashtëm.
2. Botimet e Institutit mbajnë në ballinë logon dhe emrin e institucionit dhe kanë një formatim të jashtëm identifikues.
3. Botimet e Institutit në gjuhën shqipe duhet të kenë rezymenë në gjuhën angleze, ndërsa botimet në gjuhën angleze duhet të kenë rezymenë në gjuhën shqipe.
4. Instituti realizon edhe botime që dalin nga bashkëpunimi me institucionet shkencore e universitare brenda dhe jashtë vendit.
5. Botimet e Institutit pajisen me ISBN dhe CIP, ndërsa revistat me ISSN.

Neni 3

Redaksitë, vlerësimi dhe miratimi i dorëshkrimeve

1. Kryeredaktor i botimeve të Institutit është drejtori/ja.
2. Këshilli shkencor miraton për vlerësim profesional dhe shkencor dorëshkrimet e dorëzuara për botim.
3. Këshilli shkencor shqyrton vetëm dorëshkrimet e dorëzuara për vlerësim nga organet kompetente të Institutit, të cilat në këtë procedurë janë emëruar për shqyrtim nga drejtori/ja.
4. Këshilli Shkencor përzgjedh recensentët dhe redaktorët shkencor të veprave të miratuara në parim për vlerësim, pas propozimit nga drejtori/ja.
5. Revista shkencore “Kosova” organi periodik i Institutit ka redaksinë e veçantë me anëtar kombëtar dhe ndërkombëtar, e cila merret me organizimin e punës dhe zhvillimin e revistës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
6. Redaksia e revistës mbikëqyr cilësinë e përgjithshme të punimeve shkencore të publikuara në revistën “Kosova” dhe sigurohet që niveli i botimeve të jetë cilësor dhe kompatibil për indeksimet në platformat kredibile ndërkombëtare.
7. Redaksia e revistës shkencore “Kosova” me kryeredaktor drejtorin/en e Institutit përcakton recensentët anonim, nga radhët e studiuesve më eminent të fushës për çdo dorëshkrim të punimit të dorëzuar të cilët nuk janë anëtar të redaksisë dhe punonjës të Institutit.
8. Të gjitha punimet e botuara në revistën “Kosova” dhe në periodikët e tjerë duhet të indeksohen në platformën dhe databazën elektronike të përcaktuar nga Instituti, nëpërmjet indeksimit të titullit të punimit, abstraktit në gjuhën shqipe dhe angleze dhe fjalët kyçe të secilit artikull shkencor të botuar.
9. Për botim në revistën “Kosova” punonjësit shkencor të Institutit obligohen që çdo vit kalendarik të dorëzojnë punimet në dorëshkrim për botim. Mund të paraqesin dorëshkrimet e tyre punonjësit shkencor të institucioneve tjera simotra, si dhe punonjësit shkencor të pavarur kombëtar dhe ndërkombëtar, kandidatët e doktoratës dhe në rastet e veçanta studiuesit e studimeve postdiplomike, të cilët kanë dhënë rezultate të rëndësishme në historiografi.
10. Punimet shkencore të miratuara për botim në revistën “Kosova” duhet të jenë dorëshkrime origjinale të pa botuara me parë.
11. Punimet shkencore në revistën “Kosova” mund të botohen në gjuhën shqipe dhe angleze.
12. Kryeredaktori i botimeve të veçanta, sipas këtij neni cilësohet në masën 50% të autorit të veprës monografike për nevojat e pagesës autoriale.

13. Instituti ka komisionet e botimeve të veçanta të cila shqyrtojnë kërkesat për botimet nga autorët e jashtëm të Institutit. Kryeredaktor i botimeve të veçanta është drejtori/ja.
14. Sekretari shkencor është sekretar i redaksisë së revistës “Kosova” dhe botimeve të veçanta.
15. Propozimet e organeve kompetente të botimeve të veçanta diskutohen për vendim miratues apo refuzues në Këshillin shkencor.
16. Redaktori shkencorë caktohet të botimet e veçanta. Redaktori shkencor i botimeve të veçanta, sipas këtij neni cilësohet në masën 30% të autorit të veprës monografike për nevojat e pagesës autoriale.
17. Redaktori shkencorë për botime të veçanta tematike me shumë autorë, sipas këtij neni cilësohet në masën 50% të autorit të veprës monografike për nevojat e pagesës autoriale.
18. Recensentët, caktohen në të gjitha llojet e botimeve dhe vlerësimin e dorëshkrimit duhet ta japin me shkrim.
19. Redaktorët shkencorë dhe recensentët duhet të jenë nga Instituti, nga fusha e ngushtë e studimit ose e përafërt.
20. Redaktorët shkencorë dhe recensentët mund të jenë nga bashkëpunëtorët e jashtëm vetëm në raste kur brenda punonjësve të Institutit nuk ka të tillë.

Neni 4

Redaksia e botimeve periodike

1. Instituti publikon botime periodike: revistë shkencore dhe buletin.
2. Instituti ka organin periodik të saj, revistën shkencore “Kosova”.
3. Redaksia e revistës siguron anonimitetin e recensentëve që bëjnë vlerësimin paraprak të punimeve për pranimin e tyre për botim.
4. Për miratimin e dorëshkrimit për botim nevojitet vlerësimi pozitiv i tre recensentëve.
5. Redaksia respekton rreptësishtë standardet ndërkombëtare të katalogimit dhe indeksimit shkencor (titull, abstrakt dhe fjalët kyçe në gjuhën angleze). Përmbushja e këtyre kritereve verifikohet në vijimësi.
6. Siguron periodicitet të rregullt.
7. Redaksia mbanë lidhje me institucionet e indeksimit ndërkombëtar dhe ka për detyrë rritjen e cilësisë shkencore përmes përfshirjes së tyre në listat e njohura të renditjes shkencore në botë.
8. Redaksia e revistës “Kosova” ka dymbëdhjetë (12) anëtar prej të cilëve deri në gjashtë(6) mund të jenë ndërkombëtar.

9. Kriteret, afatet dhe procedurat e pranimit të artikujve shkencorë për botim në revistën “Kosova” përcaktohen në rregullore të veçantë të revistës.
10. Prezantimi i dorëshkrimit të artikullit shkencor për shqyrtim dhe botim në revistën “Kosova” do të realizohet në formë elektronike në një platformë të veçantë interaktive në internet për qasje të lehtë dhe qasje ndërkombëtare.
11. Botimet e mëhershme të revistës “Kosova” do të prezantohen në formë elektronike dhe fizike në arkivin e revistës.
12. Punimet e botuara do të prezantohen në platformën elektronike të veçantë të revistës “Kosova” në gjuhën shqipe në një faqe të veçantë si dhe në gjuhën angleze në një faqe të veçantë.
13. Revista “Kosova” botohet në gjuhën shqipe dhe botimi i njëjtë mund të publikohet edhe në gjuhën angleze.
14. Punimet shkencore të botuara në revistën “Kosova” kompensohen në vlerën e dy tabakëve të autorit të monografisë. Ndërsa materialet dhe recensionet kompensohen në vlerën e dy tabakëve të autorit të dokumenteve dhe materialeve.
15. Këshilli shkencor miraton anëtarët e redaksive të revistave dhe botimeve të tjera të Institutit të propozuara nga drejtori/ja i Institutit.
16. Instituti realizon botimin e rezultateve kërkimore-shkencore përmes revistave, monografive, botimeve të veçanta, studimeve, materialeve, dokumenteve dhe botimeve digjitale.
17. Revista “Kosova”, botohet në secilin vit kalendarik. Publikimi i saj do të realizohet deri në gjysmën e parë të vitit pasues, pas dorëzimit të dorëshkrimeve të punimeve, përzgjedhjes, recensimit dhe sistemimit përkatës.

Neni 5

Llojet e botimeve

1. Veprimtaria botuese përfshin botimet e rregullta dhe të veçanta.
2. Botimet e rregullta përfshijnë veprat që botohen në kuadër të veprimtarisë së paraparë në programin e punës së Departamenteve të Institutit.
3. Botimet e Institutit përfshijnë studimet monografike, përmbledhjet me dokumente, përmbledhje me punime dhe materiale tjera individuale; përmbledhjet e kumtesave të konferencave, tryezave shkencore dhe të aktiviteteve të tjera shkencore, botimeve biografike, leksikonëve, botimet enciklopedike.
4. Studimet monografike, janë botimet origjinale në mënyrën e hartimit, që për objekt studimi kanë një tematikë të caktuar, e cila është e

- shoqëruar me metodologji shkencore, referenca, analiza dhe rezultate konkrete shkencore. Të tilla mund të jenë studimet e paraqitura si projekte individuale apo grupe në Institut, disertacionet etj. Në kuadër të studimeve monografike nuk bëjnë pjesë biografit e disa personave apo materialet e karakterit enciklopedikë.
5. Përmbledhjet me dokumente, janë botime që përfshijnë dokumente me rendësi për historinë tonë, të nxjerra drejtpërdrejt nga burimet arkivore, ose nga dokumente të botuara në gjuhët origjinal, të renditura në formë kronologjike apo tematike. Librat me dokumente, duhet të jenë në dy gjuhë: në gjuhën e origjinalit dhe në përkthim në gjuhën shqipe. Të tilla mund të jenë dokumentet kushtuar një tematike apo periudhe historike të caktuar.
 6. Përmbledhje me punime dhe materiale tjera individuale, janë botimet që përmbajnë artikuj, kumtesa, vështrime, recensione etj. (të përzgjedhura), të autori të botuara më parë ndër vite.
 7. Përmbledhjet e kumtesave apo akteve të konferencave, tryezave shkencore dhe të aktiviteteve të tjera shkencore, janë botimet që përmbajnë kumtesat, akte dhe materiale, nga këto aktivitete grupe, të cilat i nënshtrohen vlerësimit të redaksisë së përkohshme. Të tilla mund të jenë kumtesat, aktet dhe materialet e ndonjë përvjetori apo ngjarje të caktuar.
 8. Materialet biografike, janë ato botime që për objekt trajtimi kanë biografitë e një personi apo shumë personave. Të tilla mund të jenë biografitë e studiuesve të një fushe apo tematike të caktuar, materialet me biografitë e luftëtarëve, biografitë e dëshmorëve, të vrarëve apo të masakruarave në një zonë apo qytete të caktuar.

Neni 6

Kërkesa për botim

1. Kërkesës për botim duhet t'i bashkëngjitet dorëshkrimi i veprës e cila do të nënshtrohet vlerësimit nga organet kompetente.
2. Dorëshkrimet i paraqiten drejtorit/es të Institutit, së bashku me kërkesën/deklaratën e autorit, në të cilën bëhet e qartë se cilës kategori i takon dorëshkrimi në fjalë (botim shkencorë, dokumente arkivore, vështrim biografikë, përmbledhje punimesh e materialesh etj.) dhe se nuk është botuar ose është botuar pjesërisht. Në deklaratën e autorit duhet të saktësohet përqindja e dorëshkrimit të pabotuar.
3. Me rastin e dorëzimit të dorëshkrimit autori nënshkruan deklaratë për origjinalitet të punimit dhe për përgjegjësit e veta. Për saktësinë e deklaratës përgjegjësinë e mban autori.

4. Dorëshkrimet dorëzohen në versionin elektronik, në WORD, si dhe në letër 2 (dy) kopje.
5. Dorëshkrimet e dorëzuara për botim duhet të pajisen me rezymenë në gjuhën angleze, burimet dhe literaturën si dhe shtojcat përkatëse varësisht nga natyra e botimit si: faksimilet, fotografitë, hartat, skicat, grafikët, tabelat.
6. Me bashkëpunëtorin e jashtëm (studiuesin) i cili boton në kuadër të Instituti, Instituti paraprakisht lidh kontratë, më të cilën parashihet:
 - 6.1. Instituti formon një komision vlerësues, prej dy anëtarësh të emëruar nga drejtori/ja për vlerësimin e studimit, për të cilin ofrojnë mendim me shkrim;
 - 6.2. Autori i librit (studimit), me daljen e botimit nga shtypi obligohet që botuesit (Instituti) t'ia dorëzon 50 ekzemplarë;
 - 6.3. Autori i librit (studimit) merr përsipër kompensimin e kryeredaktorit dhe recensentëve të librit si dhe shpenzimet e tjera.

Neni 7

Vlerësimi i dorëshkrimeve

1. Dorëshkrimet e dorëzuara për botim i nënshtrohen vlerësimin nga ana e redaksisë, recensentëve.
2. Dorëshkrimet merren në konsideratë për botim nëse nuk janë botuar ose janë botuar pjesërisht si libër autorial.
3. Recensentët e caktuar për të vlerësuar një dorëshkrim, paraqesin me shkrim vlerësimin/mendimin e tyre, nëse dorëshkrimi i veprës i plotëson ose jo kushtet dhe kriteret e botimit. Recensentët vlerësimin për dorëshkrimin duhet ta dorëzojnë brenda 30 ditëve.
4. Dorëshkrimi i refuzuar, mund të riparaqitet edhe njëherë pas plotësimit të kriterëve shkencorë për botim.
5. Pas miratimit të dorëshkrimit nga Këshilli shkencor procedurat për shtyp mbikëqyren nga drejtori/ja dhe sekretari shkencor.

Neni 8

Ribotimit

1. Instituti nuk i boton dorëshkrimet që janë botuar në tërësi të një botues tjetër.
2. Ribotimi i veprave të botuara nga Instituti mund të realizohet nëse vlerësohet rëndësia e ribotimit.
3. Procedurat e ribotimit janë të njëjta me ato të botimit.
4. Prioritet do t'i jepet ribotimit të veprës në gjuhën angleze, apo në ndonjë gjuhë botërore. Ribotimi i veprës në gjuhën angleze mund të realizohet në marrëveshje me palën e tretë.
5. Ribotim i veprës realizohet nga Instituti në marrëveshje me autorin.

Neni 9

Botimi dhe shtypi

1. Shtypja e botimeve realizohet në formate të standardizuara. Format standard i botimeve të Institutit është: Revista "Kosova", duhet ta kenë formatin 17x24, fondi i shkronjave Times New Roman, madhësia e shkronjave 12, distanca mes rreshtave 1.15, letra 80 gram e bardhë, shkronja të zeza pa ngjyra. Monografitë, përmbledhjet me dokumente, përmbledhjet me punime dhe materialet tjera individuale; përmbledhjet e kumtesave të konferencave, tryezave shkencore dhe të aktiviteteve të tjera shkencore, botimet biografike, leksikonët, botimet enciklopedike, duhet ta kenë formatin 16x23, fondi i shkronjave Times New Roman, madhësia e shkronjave 12, distanca mes rreshtave 1.15, letra 80 gram e bardhë, shkronja të zeza pa ngjyra.
2. Pas vlerësimit pozitiv nga organet kompetente, përgatitja e botimit realizohet në lektorim dhe redaktim gjuhësor nga ana e përkrahjes profesionale të veprimtarisë shkencore.
3. Botimet e Institutit kanë, në kopertinë dhe në faqen titullare, në pjesën e sipërme, emrin e Institutit, të shënuar: "Instituti i Historisë "Ali Hadri", kurse në pjesën e poshtme shënohet: logo e Institutit, vendi i botimit: "Prishtinë" dhe viti i botimit.
4. Në fletën e parë brenda kopertinave (*recto*) shënohet në gjuhën shqipe emri i autorit i shoqëruar me titullin e librit; në fletën e parë (*verso*), shënohet: titulli i veprës, emri i botuesit "Instituti i Historisë "Ali Hadri"; kryeredaktori; recensentet, shënime të tjera teknike dhe e drejta e autorësisë "©"Copyright (autori) dhe e drejta për botim "©"Copyright ("Instituti").

5. Në faqen titullare (fleta 2, faqe 3) në *recto* shënohen me shkronja kapitale emri i Institutit: "INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI"; emri i autorit/autorëve, titulli dhe nëntitulli i librit, logoja e Institutit, vendi dhe viti i botimit të librit. Në faqen titullare, *verso*, jepen shënimet e faqes titullare edhe në gjuhën angleze.
6. Në botimet e akteve apo materialeve të aktiviteteve shkencore shënohen emrat e anëtarëve të Këshillit organizues të aktivitetit përkatës.
7. Në faqen e fundit të botimit shënohen emrat e: dizajnerit, fotografit, notografit, shtypit dhe shërbimeve të tjera teknike.
8. Botimet e veçanta mund të kenë zgjidhje teknike dhe artistike të veçantë.
9. Në raste kur botimi është realizim i përbashkëta me institucione tjera, emri i institucionit tjetër shënohet krahas emrit të Institutit.
10. Nga ekzemplarët e botimit, 100 ekzemplarë i takojnë autorit dhe bashkautorit, të tjerat botuesit, përkatësisht Institutit. Instituti, e bënë shpërndarjen e ekzemplarëve në Bibliotekën e Institutit të Historisë, në Bibliotekën Kombëtare (ekzemplarët e detyrueshëm) dhe në institucione tjera kërkimore-shkencore, universitare, arsimore e kulturore brenda dhe jashtë vendit.
11. Për veprën autoriale të botuar autori dhe realizuesit e veprës kompensohen sipas rregullores së veçantë të Institutit.
12. Të hyrat vetanake nga shitblerja-paratë e imta të tirazhit të librave të botuara nga Instituti, do të shfrytëzohen për hulumtime shkencore-arkivore.
13. Dizajnin përfundimtar para shtypit, dhe komunikimin me shtypshkronjën e miraton drejtori.
14. Tirazhi i botimeve të mëparshme të Institutit do të distribuohet si vijon: dhjetë (10) në bibliotekën e Institutit, 1/3 në bibliotekat e Kosovës dhe ndërkombëtare, 1/3 për korpusin e librave në shitje të Institutit dhe pjesa e mbetur për institucionet edukativo arsimore dhe shkollore të Kosovës.
15. Instituti do ta përditëson në baza vjetore inventarin e tirazhit të librave në shitje.
16. Distribuimi dhe shitja e botimeve të Institutit mund të zbatohet nga libraritë e regjistruara në Kosovë dhe jashtë saj, si dhe në platformat online, duke u përcaktuar shuma bazë e shitjes nga ana e Institutit. Vlera e përgjithshme në treg e librit përcaktohet nga libraria.

Neni 10

Dhurimi i botimeve

1. Instituti ndan pa kompensim nga një kopje të çdo botimi:
 - 1.1. Për të gjithë punonjësit dhe ish punonjësit e Institutit;
 - 1.2. Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
 - 1.3. Ministrisë së Kulturës, Rinis dhe të Sporteve;
 - 1.4. Ministrisë së punëve të Jashtme dhe Diasporës;
 - 1.5. Qeverisë së Kosovës;
 - 1.6. Presidencës së Kosovës;
 - 1.7. Kuvendit të Kosovës;
 - 1.8. Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë;
 - 1.9. Bibliotekës së Institutit Albanologjik të Prishtinës;
 - 1.10. Bibliotekës së Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës;
 - 1.11. Instituteve shkencore më të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi;
 - 1.12. Bibliotekave të Universiteteve publike dhe private të Kosovës;
 - 1.13. Bibliotekave të qyteteve të Kosovës.
2. Bibliotekës Kombëtare të Kosovës kopjet i jepen sipas ligjit në fuqi.
3. Më kërkesë të institucioneve ose të studiuesve të interesuar, mund tu dhurohen botimet e Institutit.
4. Në Bibliotekën e Institutit mbesin nga dy kopje të secilit botim.
5. Të gjitha botimeve që dhurohen u vihet vula “Dhuratë” e Institutit.

Neni 11

Etika në botime

1. Pranimi i kontributeve shkencore bëhet në përputhje me rregullat e etikës së botimit.
2. Kontributet shkencore duhet respektuar rreptësishtë kërkesat në lidhje me autorësinë dhe ndalimet për dorëzimin e dyfishtë, plagjiaturën, manipulimin e figurave dhe konfliktin e interesit.
3. Për shkeljen e etikës profesionale shkencore të botimit, përgjegjës është autori.

Neni 12

Lidhja e marrëveshjes

1. Dorëshkrimi dorëzohet në shtyp pasi të lidhet marrëveshja sipas kushteve të parapara me këtë Rregullore.
2. Në marrëveshje, përveç të tjerave, përfshihen këto elemente:
 - 2.1. Emri dhe adresa e kontraktuesve;
 - 2.2. Titulli i veprës që botohet;
 - 2.3. Lloji i botimit, të përcaktuar në nenin 5 të kësaj Rregulloreje;
 - 2.4. Vëllimi i veprës në tabakë autori, respektivisht numri i faqeve;
 - 2.5. Shuma, mënyra dhe afatet e pagesës së honorarit të autorit (në raste kur paguhet honorari);
 - 2.6. Tirazhi;
 - 2.7. Numri i ekzemplarëve që i jepen autorit pa kompensim.
3. Marrëveshja nënshkruhet nga dy palët. Në emër të Instituti, e nënshkruan drejtori/ja.
4. Instituti nuk obligohet lidhur me afatin për shtypjen e dorëshkrimit.
5. Për qëllime financiare, zyra e financave të Institutit përpilon faturën e shpenzimit të botimit përkatës lidhur me pagesën e autorësisë të cilën e nënshkruan drejtori/ja dhe autori i veprës. Palëve u takon nga një kopje e këtij dokumenti. Ky dokument ka fuqi ekzekutive.

Neni 13

Dispozitat përfundimtare

1. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Institutit të Historisë.

Kryesuesi i Këshillit Drejtues
Prof. Dr. Teuta Shala-Peli

